



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.298/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Deçan, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të vendvotimit, gjatë heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, dhe Koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Deçan, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 2,500.00 (dymijepesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 12.06.2017, nga BIRN/IKS, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të procesit të votimit ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi dy CD. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 11.06.2017, në qendrën e votimit numër 0101c, tek shkolla “Vëllezërit Frashëri”, në Deçan, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatëve për deputet, për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, të ngjitur në largësi prej 70 hapa larg qendrës së vendvotimit. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e koalicionit është bërë shkelje e nenit 36, pika a, të LPZ-së.

Në përgjigjen në ankesë të koalicionit PDK-AAK-NISMA, të datës 13.06.2017, pretendojnë se dëshmitë e ofruara nuk janë të sakta dhe se largësia e vendosjes së posterave nuk matet me hapa por siç është përcaktuar me ligj. Po ashtu thekson se ankesa është e paafatshme dhe ngase vendvotimet janë hapur në ora 7:00, me datë 11.06.2017, ndrysa raportimi është bërë me 12.06.2017, në ora 16:30, që do të thotë se nuk është shfrytëzuar afati 24 orësh.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD-të e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posterat e kandidatëve për deputet nga

Koalicioni PDK-AAK-NISMA, kanë qenë të vendosur në objekt afër qendrës së votimit 0101c, në shkollën “Vëllezërit Frashëri”, në Deçan, gjatë heshtjes zgjedhore, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 298/2017 më datën 14.06.2017



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.